

**Plotësim i Rregullës mbi Auditimin e Jashtëm dhe Auditorët e Jashtëm të Institucioneve  
financiare të liçencuara nga Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës  
Autorizuar sipas Nenit 62 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/47**

**Neni 1  
Përkufizimi dhe qëllimi i kësaj Rregulle**

**1.1 Përkufizimi i rregullës**

Kjo Rregull ka të bëjë me aprovimin e auditorëve të jashtëm nga AQBK-ja, si të auditorëve po ashtu edhe të firmave audituese të institucioneve financiare të liçencuara, të mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AQBK, regjistrimi i auditorëve të tillë nga ana e AQBK-së dhe kërkesat për kryerjen e auditimit të jashtëm të klientëve të tillë për auditim.

Termi “institucion financiar” është i definuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/47 mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës.

**1.2 Qëllimi i Rregullës**

Qëllimi i kësaj Rregulle është të forcojë kornizën rregullatore që ka të bëjë me auditorët e jashtëm të institucioneve financiare në Kosovë dhe të përcaktojë kualitetin e shërbimeve të ofruara nga auditorët e jashtëm, në raport me rreziqet specifike të sektorit financiar.

**Neni 2  
Aprovimi i Auditorëve**

**2.1 Aprovimi i auditorëve dhe firmave për auditim**

**2.1.1 Kushtet e përgjithshme**

Auditorët e institucioneve financiare të liçencuara, të mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AQBK-ja, duhet të aprovohen nga AQBK-ja.

Bazuar në aplikacionin e shkruar, AQBK-ja do të aprovojë si auditor të institucioneve financiare vetëm:

- 1 Një auditor të liçencuar në Kosovë në pajtim me Rregulloren Nr. 2001/30 mbi themelimin e Bordi Kosovare Mbi Standardet dhe Raportim Financiar dhe regjimin e raportimit financiar të Organizatave të Biznesit, dhe mbajtjen e anëtarësisë në një shoqatë profesionale të kontabilitetit në Kosovë, ose
- 2 Një firmë auditimi të liçencuar në Kosovë në pajtim me Rregulloren Nr. 2001/30 mbi themelimin e Bordi Kosovare Mbi Standardet dhe Raportim Financiar dhe regjimin e Raportimit financiar të Organizatave të Biznesit, dhe mbajtjen e anëtarësisë në një shoqatë profesionale të kontabilitetit në Kosovë. Auditorë të cilët kryejnë auditimet në emër të firmës duhet të jenë auditor të liçensuar në Kosovë, në pajtim me rregulloren e përmendur në fjalinë e mësipërme.

- 3 Një auditor të huaj apo një firme të huaj të auditimit që i plotëson kërkesat për liçensim të Bordit Kosovar Mbi Standardet dhe Raportim Financiar. Në veçanti, pala e huaj duhet të jetë në pajtim me kërkesat për liçensim të Udhëzimit Administrativ të Bordit no. 2002/5 dhe të ndonjë udhëzimi vijues mbi liçensim.

### **2.1.2 Kushtet specifike dhe kërkesat**

- (a) Aprovimi që i jepet auditorit apo firmës për auditim është i kufizuar për një institucion specifik financiar dhe është valid për një vit financiar.
- (b) Aplikacionet për aprovim duhet të dorëzohen në AQBK para 30 Qershor-it të secilit vit.
- (c) Auditori apo firma audituese së bashku me aplikacionin për aprovim duhet t'ia siguroj AQBK-së:
  1. një program të auditimit për auditimin e institucionit financiar, dhe
  2. një përshkrim për shfrytëzimin e burimeve gjatë shërbimit të auditimit.
- (d) Programi i auditimit dhe shfrytëzimi i burimeve gjatë shërbimit të auditimit, duhet të jenë mjaft adekuat në raport me karakterin dhe madhësinë e institucionit financiar.
- (e) Punësimi i vazhdueshëm i auditorit të njëjtë te jashtëm ose firmës audituese është i kufizuar në pesë vite apo pesë auditime të njëpasnjëshme.

### **2.2 Reputacioni i mirë**

AQBK-ja do të aprovoj si auditor të institucioneve financiare, auditorët apo firmat audituese që kanë reputacion të mirë dhe të cilat nuk janë të angazhuara në asnjë aktivitet, i cili është në mos përputhshmëri me funksionet e auditimit të jashtëm.

### **2.3 Tërheqja e aprovimit**

1. Aprovimi i një auditori apo firme audituese do të tërhiqet, nëse reputacioni i mirë i atij personi apo firme është kompromentuar seriozisht.
2. Aprovimi i një auditori apo firme audituese do të tërhiqet nëse njëri nga kushtet e vëna në Nenin 2.1 dhe 2.2 nuk përmbushet më. Sidoqoftë, AQBK-ja mund të ofroj periudhën prej jo më shumë se gjashtë muaj me qëllim të përmbushjes së këtyre kërkesave.

## **Neni 3 Regjistrimi i auditorëve dhe firmave për auditim**

Auditorët dhe firmat audituese duhet të jenë të regjistruara në autoritetet e duhura siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/30.

## **Neni 4** **Etika profesionale**

Auditorët duhet t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale, e cila të paktën do të përfshijë përgjegjësinë e auditorit apo firmës për auditim ndaj publikut, integritetin dhe objektivitetin si dhe kompetencën e tyre profesionale dhe kujdesin e duhur.

## **Neni 5** **Pavarësia**

### **5.1 Pavarësia dhe objektiviteti**

Gjatë kryerjes së auditimit, auditorët duhet të jenë të pavarur nga entiteti që auditohet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në vendimet e menaxhmentit të entitetit që auditohet. Auditorët apo firmat audituese nuk duhet të kryejnë auditimin, nëse ekziston ndonjë marrëdhënie direkte apo indirekte financiare, pune, punësimi apo çfarëdo marrëdhënie tjetër, përfshirë edhe provizionin për shërbimet jo-audituese shtesë, ndërmjet auditorit ose firmës audituese dhe entitetit që auditohet, nga e cila një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar do të mund të konkludonte se pavarësia e auditorit ose firmës audituese është kompromentuar.

Auditorët e licënuar, gjithashtu, duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Rekomandimit të Komisionit të BE-së të 16 Maj-it 2002, Pavarësia Statutore e Auditorëve në BE: Struktura e Parimeve Fundamentale. Për më tepër, AQBK-ja do të siguroj pajtueshmëri me Kapitullin IV të Direktivës së BE 2006/43 mbi auditimet statusore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara.

Auditorët duhet të dokumentojnë me shkrim në letrat e punës së auditimit, të gjitha kërcënimet e pavarësisë së tyre si dhe masat e sigurisë që i kanë ndërmarrë për zbutjen e atyre kërcënimeve.

### **5.2 Pavarësia dhe objektiviteti i auditorëve të cilat kryejnë një auditimi në emër të firmave audituese**

Pronarët apo aksionarët e një firme audituese, gjithashtu edhe anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të asaj firme, apo të një firme të asociuar, nuk duhet të ndërhyjnë në ekzekutimin e ndonjë auditimi në çfarëdo mënyrë e cila do të rrezikonte pavarësinë dhe objektivitetin e auditorit i cili kryen auditimin në emër të firmës audituese.

### **5.3 Tarifat e auditimit**

Tarifat e shërbimeve të auditimit:

- (a) Duhet të jenë adekuate qe te mundësojnë kualitetin e duhur të auditimit;
- (b) Nuk duhet të jenë të influencuara apo të përcaktuara nga provizioni i shërbimeve plotësuese të institucionit financiar që auditohet;
- (c) Nuk mund të bazohen në asnjë formë të kushtëzimit.

## **Neni 6**

### **Kërkesat ndaj auditorëve në kryerjen e auditimit të llogarive vjetore, etj.**

#### **6.1 Standardet e auditimit**

Auditorët duhet të kryejnë të gjitha auditimet e institucioneve financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).

#### **6.2 Përmbytja e auditimit**

Auditorët duhet të vlerësojnë nëse llogaritë vjetore të institucioneve financiare janë apo nuk janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar, me rregullat përkatëse dhe rregullat e AQBK-së, si dhe të vlerësojnë nëse menaxhmenti i institucionit financiar e ka plotësuar apo jo obligimin e tij, për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura si dhe dokumentimin e informatave kontabël, në pajtim me rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së. Auditorët duhet të vlerësojnë nëse informatat në raportet vjetore lidhur me llogaritë vjetore supozimet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së, dhe nëse informata është në pajtim me llogaritë vjetore.

Auditorët duhet të sigurohen që institucionet financiare kanë siguruar menaxhim të kënaqshëm të mjeteve dhe nëse janë vendosur kontrollat të duhura.

Auditorët duhet që nëpërmes të auditimeve, të kontribuojnë në parandalimin dhe shpалosjen e parregullësive dhe gabimeve.

#### **6.3 Detyrat e auditorëve**

Auditorët duhet të ekzekutojnë auditimet sipas gjykimit të tyre më të mirë përfshirë vlerësimin e rrezikut, që paraqet përfshirja e informatave të gabuara në llogaritë vjetore për shkak të parregullësive dhe gabimeve. Auditorët duhet të sigurojnë që posedojnë një bazë adekuate për të vlerësuar nëse është bërë ndonjë shkelje e rregulloreve dhe rregullave të AQBK-së, të cilat janë domethënëse sa i përket llogarive vjetore.

Auditorët duhet t'ia paraqesin me shkrim, menaxhmentit të institucioneve financiare, rrethanat e poshtëshënuara:

1. Mangësitë në lidhje me detyrimin për të siguruar regjistrimin e duhur, shpалosjen e qartë dhe dokumentimin e informatave kontabël;
2. Gabimet dhe mangësitë në organizimin dhe kontrollin e menaxhimit të mjeteve;
3. Parregullsitë dhe gabimet që mund të shkaktojnë informim të gabuar në llogaritë vjetore;
4. Rrethanat që mund të shkaktojnë detyrime të anëtarëve të Bordit, asambleve të korporatave, komiteteve të përfaqësuesve të aksionarëve apo menaxherëve të përgjithshëm.

## **6.4 Dokumentimi i kryerjes së detyrës**

Auditorët duhet të jenë në gjendje për të dokumentuar mjaftueshëm se si është kryer një auditim, si dhe rezultatet e një auditimi. Çështjet të cilat tregojnë se parregullsitë dhe gabimet që mund të jenë të pranishme duhet të dokumentohen veçmas.

Në rast të kryerjes së shërbimeve konsultative si dhe shërbimeve tjera për institucionet financiare, auditorët duhet të jenë në gjendje të dokumentojnë natyrën e një pune të tillë, përkufizimin e saj dhe të ndonjë rekomandimi. Shërbimet e tilla duhet të faturohen ndaras së bashku me një deklaratë për natyrën e punëve të tilla.

## **6.5 Mirëmbajtja e letrave të punës së auditimit**

Letrat e punës së auditimit duhet të mirëmbahen në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe standarde të vendosura nga profesioni i auditimit.

## **6.6 Raportet e auditorëve dhe letra e menaxhmentit**

### **6.6.1 Raporti i auditimit**

Auditorët duhet të dërgojnë një raport vjetor të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së.

Raporti i auditimit, duhet të konfirmoj që shërbimet e auditimit janë kryer në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së.

Raporti i auditimit duhet të shpreh një opinion në lidhje me çështjet në vijim:

1. Nëse llogaritë vjetore janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar, rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së, dhe paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare dhe aktiviteteve të institucionit financiar,
2. Nëse menaxhmenti i institucionit financiar e ka përmbushur obligimin e tij, për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura si dhe dokumentimin e informatave kontabël; dhe
3. Nëse informatat në raportin vjetor përshtaten në lidhje me llogaritë vjetore, supozimet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së, dhe nëse informata është në pajtim me llogaritë vjetore.

Nëse llogaritë nuk japin informatat lidhur me rezultatin dhe gjendjen e institucionit financiar, e që duhet të sigurohen, auditorët duhet të theksojnë këtë, ose të përcaktojnë rezervat e auditorëve dhe mundësisht të sigurojnë edhe informata të nevojshme plotësuese në raportin e auditimit.

Nëse auditorët arrijnë në përfundim se llogaritë nuk duhet të finalizohen në formën e tyre aktuale, kjo duhet të theksohet në mënyrë të qartë.

Nëse auditorët, gjatë kryerjes së auditimit, zbulojnë rrethanat që mund të shkaktojnë detyrime të anëtarëve të Bordit, asambleve të korporatave, komiteteve të përfaqësuesve të aksionarëve apo

menaxherëve të përgjithshëm, kjo duhet të paraqitet në raportin e auditimit. Auditorët, gjithashtu, duhet të sigurojnë informata tjera në lidhje me rrethanat, për të cilat besojnë se duhet njoftuar pjesëmarrësit apo aksionarët e institucionit financiar.

Auditorët, të cilët auditojnë llogaritë vjetore të kompanisë amë të institucionit financiar, duhet të sigurojnë raport të veçantë të auditimit për grupin. Dispozitat e paragrafit një deri gjashtë, aplikohen njëjtë.

### **6.6.2 Letra e Menaxhmentit**

Auditorët, duhet që në pajtim me rregulloret relevante dhe rregullat e AQBK-së, të përgatisin letrën finale të menaxhmentit për institucionin financiar, për konkludimet e procesit të auditimit. Letra e menaxhmentit duhet të përfshij të gjitha konkluzionet në të cilat ka arritur auditori në lidhje me aktivitetin apo gjendjen financiare të institucionit financiar, si dhe informatat në lidhje me kujdesin e tyre të performuar në mision të auditimit.

Në letrën finale të menaxhmentit, auditorët, duhet të japin një deklaratë specifike, në lidhje me sistemin e kontrollave të brendshme me qëllim të japin siguri specifike mbi, dhe për qëllim të shpalesjes së çështjeve materiale në strukturën e kontrollit të brendshëm. Deklarata specifike, duhet, gjithashtu, të përfshij funksionin e auditimit të brendshëm.

## **Neni 7 Fshehtësia profesionale**

Auditorët dhe bashkëpunëtorët e auditorëve, kanë për detyrë të ruajnë fshehtësitë profesionale, sa i përket çfarëdo njohurive të përfituara gjatë kohës së aktiviteteve të tyre, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe, apo në rastet kur informata ka të bëjë me personin detyra e të cilit nuk kërkon fshehtësinë profesionale. Auditorët dhe bashkëpunëtorët e auditorëve nuk mund t'i shfrytëzojnë ato informata për aktivitetet e veta apo për shërbim apo punësim të tjerëve.

Auditorët, pa marrë parasysh pengesat e paraqitura në dispozitat e paragrafit paraprak apo të marrëveshjes për fshehtësi profesionale, mund t'i japin ndonjë shpjegim apo t'ia paraqesin policisë dokumentet, në lidhje me ndonjë auditim, apo shërbime të tjera në rastet kur fillojnë hetimet ndaj ndonjë vepre penale. Për më tepër, auditorët mund të informojnë policinë, nëse në lidhje me punën e auditimit apo shërbimeve të tjera, kanë hasur në rrethana të dyshimta të cilat japin një bazë për dyshim që të ketë ndodhur ndonjë vepër e ndëshkueshme.

Fshehtësia profesionale, do të vazhdoj të respektohet përsëri pasi që të ketë përfunduar detyra e tillë.

## **Neni 8 Obligimi për të informuar**

Auditorët duhet, brenda kornizave të një detyre, të sigurojnë informata në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me institucionin financiar, informata të cilat auditori i ka mësuar gjatë kohës së auditimit, kur kjo kërkohet nga aksionarët në mbledhjen e përgjithshme, nga pjesëmarrësit në mbledhjet e kompanisë, nga anëtarët e asambleve të korporatës, nga komiteti i kontrollit apo bordi drejtues, nga menaxheri i përgjithshëm apo nga ndonjë hetues. Sigurimi i informatave nuk është i obligueshëm, në rastet kur për t'u siguruar informata e kërkuar, duhet të dëmtohet pa nevojë institucioni financiar.

Auditori, duhet, që pa u vonuar, t'i komunikoj komitetit të auditimit apo bordit drejtues të klientit, ndonjë çështje me interes për qeverisje, të cilën e ka vërejtur gjatë kryerjes së auditimit. Auditori, duhet të njoftoj organet qeverisëse të lartpërmendura të klientit, dhe menjëherë pastaj AQBK-në, në rastet kur gjatë kryerjes së auditimit të klientit, ai vëren:

- informatën që shfaq shenja të dështimit në përmbushjen e kërkesave për liçencim nga ana e AQBK-së;
- një konflikt serioz brenda organeve vendim-marrëse apo largimin e papritur të menaxherit që ka pasur funksion kyç;
- informatën e cila shfaq shenja të shkeljeve materiale të ligjeve dhe rregulloreve, ose të statutit të klientit, ose urdhëresave; ose
- synimin e auditorit për të dhënë dorëheqje apo largimin e auditorit; dhe ndryshimet e disfavorshme apo material që paraqesin rrezik për punën e klientit dhe mundësinë që rreziku të vazhdoj.

Auditorët, duhet që, në bazë të kërkesës së AQBK-së, të siguroj AQBK-në me çfarëdo informate gjatë tërë misionit të auditimit, në lidhje me performancën e auditorit në shërbimet auditimit në një institucion financiar.

Nëse institucioni financiar nuk e përmbush obligimin e tij, për t'ia dërguar AQBK-së, dokumentet specifike, në pajtim me rregulloret përkatëse që aplikohen në kompani, atëherë auditori, me kërkesën e AQBK-së, duhet t'i dërgoj kopjet e dokumenteve të cilat ai/ajo i ka në posedim.

## **Neni 9**

### **Kontrolli i cilësisë dhe rishikimi i cilësisë së dhënies së sigurisë**

Auditorët dhe firmat audituese të aprovuara nga AQBK-ja duhet të aplikojnë politikat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë të adresojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit.

Auditorët dhe firmat audituese, të aprovuara nga AQBK-ja, do të jenë subjekt i një rishikimi të cilësisë së dhënies së sigurisë, nga ana e AQBK-së.

Rishikimi i cilësisë të një auditori apo firme audituese të aprovuar, duhet të përfshijë një detyrë specifike të auditimit dhe duhet të kryhet nga ana e një rishikuesi të caktuar nga AQBK-ja. Për qëllime të trajnimit, një rishikues ndihmës mund të caktohet nga AQBK-ja.

Gjatë rishikimit të cilësisë, rishikuesi duhet të përcaktoj se deri në çfarë shtrirje, auditori dhe firma audituese kanë aplikuar rregullat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë në të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit. Gjatë rishikimit, rishikuesi duhet të ketë qasje në të gjitha dokumentet e punës të auditorit apo firmës audituese, deri në atë masë që është e nevojshme për të kryer një kontroll adekuat të cilësisë.

Duke pasur parasysh obligimet për ruajtjen e fshehtësisë, Neni 7, dhe paragrafi i parë i kësaj rregulle aplikohen njëjtë për rishikuesin e cilësisë dhe asistentin e rishikuesit të cilësisë.

Personeli tjetër dhe menaxhmenti i AQBK-së, do të kenë qasje vetëm në dosjet dhe letrat e punës

së rishikuesit të cilësisë, por jo edhe në dosjet dhe letrat e punës të auditorit apo firmës audituese. Duke pasur parasysh obligimet për ruajtjen e fshehtësisë, paragrafi i I-rë i Nenit 7 të kësaj rregulle, vlen njëjtë edhe për personelin dhe menaxhmentin e AQBK-së.

Rezultatet e përmbledhura të rishikimit të kualitetit të cilësisë do të publikohen nga AQBK-ja, duke përfshirë rekomandimet, zbatimin e rekomandimeve dhe nëse ndodh ndonjë rast edhe sanksionet.

#### **Neni 10** **Shkarkimi dhe dorëheqja**

Auditorët e institucioneve financiare mund të shkarkohen kur ekzistojnë baza të mjaftueshme për këtë; dallimet e opinioneve të trajtimeve në kontabilitet ose në procedura të auditimit, nuk mund të konsiderohet si bazë e mjaftueshme për shkarkim.

Si institucionet e audituara financiare ashtu edhe auditorët, duhet t'a informojnë AQBK-në në rast të shkarkimit apo të dorëheqjes dhe duhet të japin arsyetimet e tyre adekuate për një vendim të tillë.

#### **Neni 11** **Sanksionet**

Nëse auditorët e institucioneve financiare i kanë shkelur detyrat e auditorit, të përcaktuara me këtë Rregull dhe me rregulloret përkatëse të AQBK-së, AQBK-ja mund t'i jap auditorit, një vërejtje apo një vërejtje serioze, varësisht nga natyra e një shkeljeje të tillë.

Nëse auditorët e institucioneve financiare në mënyrë të ashpër apo të persëritur i kanë shkelur detyrat e auditorit të përcaktuara me këtë Rregull dhe me rregulloret përkatëse të AQBK-së, AQBK-ja mund t'ua tërheq aprovimin si auditorë të një institucioni financiar.

#### **Neni 12** **Hyrja ne fuqi**

Bordi Udhëheqës i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës adoptoi këtë rregull më 19 Shkurt, 2008. Rregulla aktuale do te hyje në fuqi me 1 Mars, 2008. Në këtë mënyrë lëshimet e mëparshme të kësaj rregulle shfuqizohen .